

SI MUND TË BËHENI PJESË E TRAJNIMIT PARAPROFESIONAL?

Kusht paraprak për t'u bërë pjesë e trajnimit paraprofesional është që të keni përfunduar Trajnimin për të Rinjtë dhe të jeni regjistruar te Shërbimi Publik i Punësimit (AMS).

Të dhënat e kontaktit të Trajnimit për të Rinjtë dhe të këshilluesve/këshillueseve të trajnimit paraprofesional i gjeni në adresën www.neba.at

ÇFARË NDODH MË PAS?

Pas trajnimit paraprofesional ju mund të kryeni një praktikë

- > mësimore/formim profesional integruar në një fabrikë ose të kryeni një formim profesional të përgjithshëm,
- > të ndiqni një shkollë të mesme,
- > ose të merrni pjesë në një nga programet e kualifikimit të ofruara nga AMS-ja ose institucionet arsimore.

... FORMIM PËR TË ARDHMEN TUAJ

Autorësia

Pronar i mediave dhe botues:

Sozialministeriumservice, 1010 Wien,
Babenbergerstraße 5

Koncepti & dizajni: CM Creative

Redaktimi: Sozialministeriumservice

Fotografite: Shutterstock



SHQ



NETZWERK BERUFLICHE
ASSISTENZ

AUSBILDUNGSFIT

neba.at/ausbildungsfrit



NETZWERK BERUFLICHE
ASSISTENZ

AUSBILDUNGSFIT

"Ne përgatisim të
rinjtë për arsimim"




Kjo masë financohet nga burimet
e Fondit Social Evropian.

NEBA është një iniciativë e
Sozialministeriumservice



neba.at/ausbildungsfrit



PSE TË ZGJIDHNI TRAJNIMIT PARAPROFESIONAL ?

- > Jeni 15 vjeç ose më shumë dhe jeni në kërkim të një "formimi" ideal për veten?
- > Dëshironi të trajnoheni për aftësitë e nevojshme?

Trajnimit paraprofesional mund t'ju ndihmojë që të hidhni hapin tjetër në drejtim të formimit tuaj ideal.

Programin e trajnimit paraprofesional mund ta ndiqni deri në një vit.

... MUNDËSI ZHVILLIMI PËR PJEKURINË TUAJ PROFESIONALE



ÇFARË ËSHTË TRAJNIMI PARAPROFESIONAL?

Trajnimi paraprofesional është një ofertë për të rinjtë dhe të rriturit në moshë të re pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm, të cilët kërkojnë mbështetje për formimin e mëtejshëm arsimor ose profesional.

Trajnimi paraprofesional ju trajnon

- > për marrëdhëniet në punë (aftësia e përqendrimit, kujdesi, korrektesa, pavarësia, ...)
- > për marrëdhëniet me personat e tjerë (sjellja, paraqitja e jashtme, marrëdhënia me kritikën dhe konfliktet, ...)
- > për pjekurinë në zgjedhjen e profesionit (vlerësimi i aftësive individuale)

... TRAJNIMI PARAPROFESIONAL ËSHTË FALAS DHE JO E DETYRUESHME

SI FUNKSIONON TRAJNIMI PARAPROFESIONAL?

Trajnimi paraprofesional përbëhet nga katër shtylla:

Modulet e trajnimit

Disponohen module trajnimi me aspektet kyçe të mëposhtme:

- > Aktivizim (ndihma për nisjen fillestare)
- > Praktikë (trajnim, orientim profesional, ...)
- > Specializim (për formimin tuaj profesional të veçantë)

Trajnimi

Trajneri ose trajnerja juaj ju shoqëron gjatë gjithë kohëzgjatjes në programin e trajnimit paraprofesional, dhe:

- > diskuton me ju çdo 3 muaj progresin tuaj
- > kujdeset gjatë kurseve të trajnimit për testimin tuaj profesional në ndërmarrje të ndryshme

Fabrika e njohurive

Këtu mund të trajnoheni në mënyrën më të mirë për aftësitë e nevojshme për hapin pasardhës në drejtim të formimit tuaj.

Aktivitetet sportive

Sporti dhe ushtrimet fizike konsiderohen mjaft të rëndësishme në programin e trajnimit paraprofesional dhe ofrohen në nivele të ndryshme sipas kërkesave.

Në përfundimdo t'ju jepet edhe një hartë me mundësitë për të ardhmen tuaj